



Pranuar / Dorezuar Prunjeni/Pradato Received/Delivered	23.01.2024	9	viti god year
Organ/Bësitë Organ/Jednitca Org./Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Këmbina Quantity
SKOMSHCK	431/2024		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1432/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1432/2023 të datës 22.11.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me numër Nr.6/2023 të datës 11.10.2023 të Divizionit të për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.01.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1432/2023 e datës 22.11.2023 e parashtruar nga ankuesi**

**Mbetet në fuqi Vendimi Nr.6/2023 i datës 11.10.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.**

**A r s y e t i m**

Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 34 paragrafi (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës fillimisht më datë 09.08.2023 ka njoftuar për konkursin me numër reference Nr.ref.RN00012281, për grupin Specialistë të Farmaceutikës për pozitën e punës “*Inspektor Farmaceutik*”, në Ministrinë e Shëndetësisë ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.09.2023 deri më datën 18.09.2023.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Më datë 03.10.2023 Divizioni





për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.30/2023 përmes së cilit ankuesit i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi, së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës dhe kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkangjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (*vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse*), ashti siç është kërkuar me konkurs.

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.30/2023 të datës 03.10.2023, përmes portalit elektronik, ka parashtruar ankesë në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik. Ndërsa më datë 11.10.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.6/2023 përmes së cilit ankuesit i është refuzuar si e pabazuar ankesa për mos hyrje në listen e ngushtë me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi, së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës dhe kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkangjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (*vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse*), ashti siç është kërkuar me konkurs, ndërsa dokumentet e dërguara pas mbylljes së konkursit nuk pranohen.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.6/2023 të datës 11.10.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 22.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7057/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.12.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 12.12.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 28.12.2023 Kryesuesi i Këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit A.nr.1432/2023 ia ka vazhduar afatin e vendimmarjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 7057/2023 të datës 22.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i DMZP/MPB me numër Nr.6/2023 i datës 11.10.2023; Konkurs me emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë për pozitën e punës "Inspektor Shëndetësor", në Ministrinë e Shëndetësisë i datës 11.07.2023; Certifikatë e të punësuarit i datës 23.11.2023; Pasyra e llogarisë së trustit e i datës 08.03.2007-03.05.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 08.12.2023; Përgjigje në ankesë e datës 12.12.2023; Konkurs me emrin e grupit Specialistë të Farmaceutikës për pozitën e punës "Inspektor Farmaceutik", në Ministrinë e Shëndetësisë i datës 09.08.2023; Vendim i DMZP/MPB me numër Nr.30/2023 i datës 03.10.2023; Vendim për emërimin e komisionit të pranimit me numër Nr.01/161 i datës 25.09.2023; Aplikacioni i i datës 09.09.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e i datës 28.06.2005; Certifikatë nga qendra Boro Ramizi për



i datës 14.06.1990; Certifikatë nga [redacted] për [redacted] i datës 20.02.2018; Ankesa e ankuesit e datës 03.10.2023; CV-ja e [redacted] Certifikatë e regjistrimit nga ARBK për [redacted] i datës 06.12.2022; Letërnjoftim i Vërtetim nga [redacted] për [redacted] i datës 08.05.2023; Deklaratë për masën disiplinore e [redacted] Certifikatë mbi dënimet penale e [redacted] i datës 11.08.2023; Certifikatë shëndetësore e [redacted] i datës 11.05.2023; Licencë e punës nga OFK për [redacted] me numër RKS-1470-23; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Njoftim nga DMZP/MPB i datës 03.10.2023; Njoftim nga DMZP/MPB i datës 10.11.2023; Njoftim nga DMZP/MPB i datës 31.10.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 12.12.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 19.01.2024; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 7709/2023 i datës 28.12.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.6/2023 të datës 11.10.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i njëjti kërkon që ti aprovohet ankesa.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër Nr. të referencës RN00012281 për emrin e grupit Specialistë të Farmaceutikës, për pozitën e punës "Inspektor Farmaceutik", klasa e pozitës "Profesional I" në Ministrinë e Shëndetësië kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në Farmaci/Inxhinieri Farmaceutike/Inxhinieri Kimike me Specializim, Farmaceutikë;
- **Kualifikime të posaçme formale;** licencë për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore;
- **Përvoja e punës:** Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit; Kopjen e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkangjitet së paku njëra nga dëshmit mbështetëse si në vijim: pasqyrën pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje nuk vlen vetëm vërtetimin dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasyrat si dëshmi mbështetëse). Nuk kërkohet dëshmi mbështetëse për përvojën e punës në sektorin publik. Kopjet e licencës për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga këto dokumente është e mjaftueshme; Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati nëse ai ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur); Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës; (prezantohet nëse kandidati/ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj. Certifikatën /vërtetimin nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një vepre penale me dashje jo me të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim*



nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave referuar bazës ligjore si më lartë si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara me konkurs ashtu siç parashihen në dispozitat e Ligjit Nr.06/L –114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 dhe 1.6, ku përcaktohet se: “Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”, ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e cila përcakton se: “2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi me rastin e aplikimit nuk ka bashkëngjitur dokumentet e kërkuara sipas konkursit të lartëcekur siç janë dëshmitë nga trusti për mbulimin e dokumenteve të përvojës së punës. Kolegji i Këshillit po ashtu është njoftuar përmes e-mailit zyrtar të datës 19.01.2024 nga Zyrtari i lartë për zhvillimin e rekrutimit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP/MPB i cili ka potencuar faktin se ankuesi dëshminë e trustit e ka bashkëngjitur gjatë afatit të ankesës, me ankesë, pas afatit për aplikim në konkursin e lartëcekur.

Andaj, bazuar në faktet e lartë përmendura më sipër, konstatohet se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.6/2023 të datës 11.10.2023 ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1432/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

